



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1265/Prot.
3

Tiranë, më 26.05.2021

VENDIM

Nr. 39, datë 26.05.2021

**“ MBI PËRZGJEDHJEN E ADMINISTRATORIT TË UNIVERSITETIT TË
MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në nenin 49, gërma *f* dhe *g* të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”; nenin 51 gërma *q* dhe *r* të Statutit të UMT-së; Rregullores së Bordit të Administrimit; vendimeve nr 4, datë 14.02.2021 “Për shpalljen e konkursit për pozicionin e punës Administrator i UMT-së...” dhe nr. 36, datë 12.05.2021 “Mbi procedurën e përzgjedhjes së Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, në mbledhjen e datës 26.05.2021, Bordi i Administrimit me votim të anëtarëve prezent në mbledhje,

VENDOSI:

1. Zhvillimin e procedurës së Intervistës për pozicionin e punës Administrator, ditën e hënë, datë 31.05.2021 ora 14:30;
2. Kandidatët do të njoftohen me *e-mail* nga adresa elektronike e Bordit të Administrimit: sekretariabordiadministrimit@umed.edu.al;
3. Vendimi do të publikohet në faqen e *web-it*;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
FLORIAN TOTI**

